LIGJ
Nr. 7548, datë 8.1.1992

PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në Republikën e Shqipërisë, sistemi i taksave përbëhet nga taksat nacionale dhe ato lokale.

Neni 2

Në taksat nacionale bëjnë pjesë:
- taksa portuale;
- taksa për shërbime konsultore;
- taksa për qarkullimin e automjeteve;
- taksa për përdorimin e aparateve telefonikë;
- taksa për kryerjen e veprimeve gjyqësore e noteriale;
- taksa për regjistrimin në arsimin e lartë;
- taksa për radiokomunikimin privat.

Neni 3

Në taksat lokale bëjnë pjesë:
- taksë pulle dhe taksë mbi aktet;
- taksë regjistrimi për veprimtari të ndryshme;
- taksë pastrimi;
- taksë tregu për zënie vendi e peshëmatje;
- taksë për gjueti.

Neni 4

Në raste të veçanta kur gjykohet e domosdoshme, komiteti ekzekutiv i rrethit mund të vandosë taksa të përkohshme për shërbime në interes të banorëve të rrethit.

Neni 5

Të ardhurat që realizohen nga taksat nacionale, derdhen në buxhetin e shtetit, kurse ato që realizohen nga taksat lokale, derdhen në buxhetin e rrethit.

Neni 6

Shtetasit janë të detyruar të deklarojnë pajisjet vetjake që i nënshtrohen pagimit të taksave sipas këtij ligji.

Neni 7

Niveli i taksave përcaktohet si më poshtë:

a) taksat portuale caktohen sipas lidhjes nr.1;

b) taksat për shërbime konsullore caktohen sipas lidhjes nr.2;

c) taksa për qarkullimin e automjeteve caktohet sipas lidhjes nr.3;

ç) për përdorimin e aparateve televizive nga çdo zotërues paguhet një taksë 30 lekë në vit për çdo aparat televiziv;

d) për përdorimin e aparateve telefonike nga çdo zotërues paguhet një taksë 10 lekë në vit për çdo aparat telefonik me përjashtim të ushtarakëve të shërbimit aktiv të përhershëm që janë pajisur me telefon për qëllime gatishmërie;

dh) taksa për kryerjen e veprimeve gjyqësore dhe noteriale caktohen sipas lidhjes nr.4;

e) për regjistrimin në arsimin e lartë paguhet një taksë 20 lekë për çdo vit shkollor;

f) Taksa për radiokomunikimin privat caktohen sipas lidhjes nr.5.

Për taksat lokale;

a) Taksë pulle dhe taksë mbi aktet caktohen sipas lidhjes nr.4;

b) Taksë regjistrimi për veprimtari të ndryshme caktohet si më poshtë:

taksa e regjistrimit për veprimtaritë private është 100 lekë në vit për personat fizikë dhe 500 lekë në vit për personat juridikë. Taksa e regjistrimit për ndërmarrjet dhe pjesëmarrjen e kapitalit vendas e të huaj dhe për investimet e huaja caktohet nga 800 USD, kurse për zyrat e përfaqësimit caktohet taksa e regjistrimit 500 USD.

c) Taksë regjistrimi automjeti dhe rimorkio;

- Për motoçikleta dhe triçikla 50 lekë në vit;
- Për autoveturat, mikrobuzët, kamionët dhe kamionçinat deri në 3 tonë, 100 lekë në vit;
- Për kamionët mbi 3 tonë, 300 lekë në vit.
- Për autobuzët 500 lekë në vit.
- Për rimorkiot e çdo lloji 200 lekë në vit.

Për ushtrimin e llotarive, të konkurseve parashikuese dhe të lojrave të fatit caktohet një taksë regjistrimi prej 1000 lekësh në vit.

ç) Taksa e pastrimit caktohet 10 lekë në vit për çdo familje dhe 20 lekë për subjektet ekonomike.

d) Taksa e tregut për zënie vendi caktohet 25 lekë për m2 për çdo ditë.

Taksa e tregut për peshëmatje e kontrollin e mjeteve matëse caktohet 5 lekë për çdo ditë.

dh) Për lëshimin e lejes vjetore të gjuetisë paguhet taksa e gjuetisë 20 lekë në vit.

Neni 8

Taksa vjetore është e menjëhershme dhe paguhet brenda muajit janar të çdo viti.

Taksat e shërbimeve me karakter administrativ, gjyqësor e noterial paguhen me anë të pullës.

Neni 9

Nga pagimi i taksës së akteve dhe taksës së pullës përjshtohen:

a) Të gjitha aktet, vendimet dhe dokumentet për çështje penale, për çështje që kanë të bëjnë me pensionet ushqimore, për çështje kujdestarie, adoptimi dhe mbrojtje shoqërore, si dhe dokumentet që lëshohen për t'u paraqitur pranë institucioneve

shkollore dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Gjithashtu përjashtohen veprimet zyrtare që kërkohen nga autoritetet e huaja, me kusht reciprociteti.

b) Regjistrimi i lindjeve dhe i vdekjeve, si dhe notimet në regjistrat e gjendjes civile.

c) Pasaportat dhe vizat për studentët shqiptarë që shkojnë për studime jashtë shtetit dhe studentët e shkollave të larta ushtarake.

Përjashtohen nga pagimi i taksës së regjistrimit në shkollat e larta studentët jetimë.

Neni 10

Quhen shkelje të këtij ligji refuzimi, shmangia në ço formë tjetër dhe mosderdhja në afat e taksave.

Neni 11

Shkeljet e parashikuara në nenin 10 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, quhen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 1000 lekë.

Neni 12

Të drejtën e gjobës e kanë inspektorët e tatimeve në rrethe dhe punonjësit e Drejtorisë së Tatimeve në Ministrinë e Financave.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit të tij, përkatësisht te përgjegjësi i seksionit të financës a të drejtori i Drejtorisë së Tatimeve, akti i të cilëve është i formës së prerë.

Neni 13

Ministria e Financave të nxjerrë udhëzime për mënyrën e zbatimit e të nxjerrjes së taksave.

Neni 14

Dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 1992.

Shpallur me dekretin nr.111, datë 21.1.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha